



---

QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE  
**"NËNË TEREZA"**

---

# RAPORTI VJETOR I VEPRIMTARISE

---

2014

---

TIRANE

---

## **I. Zhvillimet kryesore gjate vitit 2014**

Gjatë vitit 2014, në QSUT u soll një frymë e re e bashkëpunimit me profesionistët e shëndetit, mjek-infermierë dhe administratës. Synimi gjatë 2014 ka qënë vënia në qëndër të shërbimeve pacientin dhe respektin ndaj tij. Me objektivin për të ndryshuar imazhin dhe rritur besimin e publikut për spitalet tona hapëm rrugët e komunikimit me strukturat mjekësore dhe me pacientët. Për t'i kthyer spitalet në vende solidariteti jo vetëm diagnostikimi dhe trajtimi.

Së bashku me shërbimet mjekësore u arrit të rivitalizohet Komisionin Mjekësor Spitalor, një strukturë e cila prej vitesh nuk funksiononte, por me të cilën jemi duke punuar për zhvillimin e strategjisë mjekësore dhe konsultimin për çdo vendimmarrje në spital.

Qendra Spitalore Universitare në veprimtarinë e saj gjatë vitit 2014 ka orientuar punën e saj në shërbimet mjekësore dhe ato jo mjekësore por të lidhura me pacientët në disa drejtime:

- ✓ Mirë administrimi i fondeve në mbështetje të shërbimeve mjekësore spitalore
- ✓ Optimizimi i proceseve të punës për të siguruar shërbime mjekësore të përshtatshme dhe cilësore për pacientët
- ✓ Sigurim i furnizimit në vazhdim me barna dhe materiale mjekësore
- ✓ Sigurim i sistemit të mirëmbajtjes së pajisjeve biomjekësore
- ✓ Laboratorë funksionale për pacientët e shtruar dhe ambulatorë
- ✓ Rritje e të ardhurave dytësore
- ✓ Përmirësim i ambienteve spitalore
- ✓ Sigurim i kushteve të punës normale për stafin mjekësor për të përmirësuar situatën problematike të trashëguar prej vitesh

**Në aspektin mjekësor janë përmirësuar** treguesit spitalorë: si rritja e xhiros së shtrimit, ulja e ditëqëndrimit rritja e ditëshfrytëzimit në Shërbimin e kardiologjisë, Pediatriisë dhe Kirurgjisë.

- Rritje e buxhetit për barnat nga 1,8 mld lekë në 2013 në 2,2 mld lekë në 2014 dhe përdorim me efikasitetet i tij.
- Rritje me 20% e sasisë së barnave të shportës bazë.
- Siguroam furnizim më të plotë e të vijueshëm të spitaleve tona me barna e materiale mjekësore. Lista që për vitin 2014 kishte 189 më shumë barna se sa në vitin 2013, ku edhe sasi të janë më të mëdha, por edhe duke dyfishuar fondet për barnat citostatikë.
- Siguroam funksionim të vijueshëm të pajisjeve kryesore biomjekësore, dhe arritëm të vendosim në gjendje të plotë pune dhe aktualisht i kemi vënë nën regjimin e kontratave të mirëmbajtjes afatgjatë të mirëmbajtjes me mbulim të plotë të rrezikut nga defektet e mundshme apo zëvendësimi i pjesëve që konsumohen nga volumi i përditshëm i përdorimit me kompanitë Siemens, Philips, Toshiba.

### **Gjatë 2014 kemi fuqizuar kapacitetet spitalore:**

- ✓ 5 EKG më shumë;
- ✓ 18 spirometra më shumë;
- ✓ Angiograf i ri për QSUT;
- ✓ Vënie në punë e akseleratorit linear në shërbimin e neurokirurgjisë;
- ✓ Pajisje të re për analizën e markuesve tumoralë në QSUT.

Në krahasimet midis vitit 2013 dhe vitit 2014 QSUT ka patur rritje të volumit të punës në shërbimet mjekësore të ofruara:

- 15% më shumë pacientë të shtruar
- 25% më shumë vizita ambulatorie të kryera
- 45% më shumë ekzaminime imazherike.
- 20% më shumë ekzaminime klinike-biokimike.
- 15% më shumë ndërhyrje kirurgjikale
- 1,5 herë më shumë sasi të shtuar barnash citostatike

### **Në aspektin e investimeve:**

Arritëm realizimin e investimeve në masën 96% për vitin 2014.

Forcuam dhe rritëm kapacitetet diagnostike dhe trajtuese në Kardiokirurgji, kardiologji, onkologji, ORL, neurologji nëpërmjet investimeve në kantierin e QSUT me:

- ✓ Pajisje të reja në vlerën 410 mijë USD më shërbimin e kardiokirurgjisë në QSUT.
- ✓ Angiograf i ri për hemodinamikën në vlerën 870,000 USD.
- ✓ Pajisje të reja për spitalin e rikonstruktuar të neurologjisë me vlerë 200 mijë USD.
- ✓ Pajisje të re për mikromanipulime me lazer në shërbimin e ORL-së, 35 mijë USD.
- ✓ Filluam ndërtimin e bunkerit të ri për akseleratorin linear në shërbimin e onkologjisë (QSUT) me kapacitet për dy njësi.
- ✓ Nëpërmjet grantit të Komisionit European me vlerë rreth 950,000 euro, është bërë i mundur rikonstruksioni i bllokut operator në Shërbimin e Djegje Plastikës, vënë në dispozicion të shërbimit në muaji mars 2014. Gjithashtu po nëpërmjet kësaj mbështetje është realizuar instalimi i një seti aparaturash dhe pajisjesh biomjekësore si edhe trajnimin i stafit ekzistues në lidhje me përdorimin e tyre.
- ✓ Përfunduam projektin e Godinës së Konsultave Ambulatore

Përfunduam financimin e të gjitha investimeve ndërtimore të nisura dhe të lëna pa financim si:

- ✓ Bunkeri i neurokirurgjisë dhe rikonstrukcionin e spitalit të neurologjisë në vlerën 1 milionë USD;

#### Përmirësimi i ambienteve spitalore dhe organizimi funksional në shërbimet mjekësore

- ✓ Organizuar në aspektin funksional Shërbimin e Urgjencës, duke përcaktuar standardin bashkëkohor të triazhimit, regjistrimin elektronik të pacientëve, pajisjen me infrastrukturë ndihmëse si dhe zonifikimin dhe kodifikimin e Urgjencës.
- ✓ Përmirësuar ambientet pritëse dhe ndihmëse të Spitalit Infektiv, të ambienteve të fizioterapisë, dhe urgjencës duke ndërhyrë në mirëmbajtjen e vazhdueshme të ambienteve.
- ✓ Përmirësuar ambientet në spitalin Onkologjik, Pediatrik dhe 6-katësh.
- ✓ Organizuar dhe ndërtuar këndin e nënave në Pediatri, një mjedis mikpritës për nënat dhe fëmijët në këtë spital.

#### Sistemi i pritjes së pacientëve – skedari elektronik i të dhënave

- Rehabilitimi i zyrës së pritjes së pacientit
- Informatizimi i këndeve të pritjes dhe pranimit të pacientëve për sistemin ambulator
- Pilotimi i kartelës elektronike në shërbimin ORL dhe shtrirja gjatë tremujorit të parë të 2015 në të gjitha shërbimet e QSUT.
- Rivitalizimi i recepsioneve në çdo spital dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve të stafit.
- Vendosja e Kutive e përshtypjeve në spitale

#### Përmirësimin e sistemit të ankesave

- Organizimi i njërive antikorrupsion në QSUT. Bashkëpunim me Ministrinë e çështjeve Vendore mbi ofrimin e të dhënave të pacientëve për vlerësimin e shërbimeve të ofruara nga QSUT nëpërmjet projektit Citizens Feedback –sms.
- Personel i fokusuar për ankesat e pacientëve në çdo njësi shërbimi shëndetësor

Në vijim të këtij raporti do të paraqitet të detajuara të gjitha arritjet dhe zhvillimet në fushat e veprimtarisë së QSUT gjatë vitit 2014.

## **II. ADMINISTRIMI I QSUT**

### **1. Treguesit financiar**


Gjatë vitit financiar 2014 Qendra Spitalore Universitare ka pasur një buxhet total prej 6.273.571.463 lekë, i financuar nga Ministria e Shëndetësisë në vlerën 258 milion lekë për sa i përket zërit të investimeve dhe nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në vlerën prej 6 miliard lekë për zërat mallra dhe shërbime, paga dhe sigurime shoqërore. Në tabelën në vijim jepen të detajuara destinacioni dhe mënyra se si janë shpenzuar këto të ardhura nga ana e QSUT.

Shpenzimet për mallra dhe shërbimi kanë përbërë rreth 66% të buxhetit total të QSUT, ndërsa pjesa tjetër prej 34% kanë qenë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore dhe investime, përkatësisht 30% paga dhe sigurime dhe 4% investime.

Zërat e shpenzimeve	Vlera	Në % mbi 602	Në % TOTALIN
<b>Barna</b>	2.220.000.240	53,53	35,39
<b>Oksigjen shëndetësor</b>	116.442.941	2,81	1,86
<b>Protoksid Azoti</b>	21.825.910	0,53	0,35
<b>Hemodializa</b>	520.234.000	12,54	8,29
<b>Mirëmbajtje aparatura dhe pajisje mejsore</b>	277.202.160	6,68	4,42
<b>SHUMA</b>	<b>3.155.705.251</b>	<b>76,10</b>	<b>50,30</b>
<b>Gjithë të tjerat</b>	<b>991.301.749</b>	<b>23,90</b>	<b>15,80</b>
<b>SHUMA</b>	<b>4.147.007.000</b>	<b>100</b>	<b>66,10</b>
<b>Paga</b>	<b>1.607.046.000</b>		<b>25,62</b>
<b>Sigurime shoq.shend</b>	<b>261.303.000</b>		<b>4,17</b>
<b>Investime</b>	<b>258.215.463</b>		<b>4,12</b>
<b>TOTALI</b>	<b>6.273.571.463</b>		<b>100</b>

Nëse do ti referohemi zërit mallra dhe shpenzime vërejmë se pjesa kryesore e shpenzimeve të këtij zëri ka qenë e destinuar për blerjen e barnave dhe materialeve mjekësore. Shpenzimet për barna dhe materiale mjekësore gjatë vitit 2014 kanë qenë rreth 2.22 miliard lekë dhe përbëjnë rreth 53% të fondeve sipas zërit mallra dhe shpenzime (Artikulli 602) ose rreth 35% të buxhetit total të QSUT. Një tjetër zë shpenzime që ka pasur një vlerë të konsiderueshme është edhe shërbimi i hemodializës i kontraktua me spitalet private. Shpenzimet për hemodializën gjatë këtij viti kanë qenë në vlerën 520 milion lekë që përbënë rreth 12.5% të totalit të zërit mallra dhe shpenzime dhe 8% e buxhetit total të QSUT.

Në grafikun në vijim paraqitet pesha e zërave kryesore të shpenzimeve për mallra dhe shërbimi.



Ndërsa tabela në vijim paraqet përqindjen e realizimit të secilit prej zërave të buxhetit.

Zërat e shpenzimeve	Plani	Realizimi	Perqindja e realizimit
<b>Mallra &amp; Shërbime</b>	4.147.007.000	4.147.007.000	100
<b>Paga</b>	1.607.046.000	1.577.597.208	98,17
<b>Sigurime shoq.shend</b>	261.303.000	260.067.801	99,53
<b>Investime</b>	258.215.463	245.265.183	94,98
<b>TOTALI</b>	<b>6.273.571.463</b>	<b>6.229.937.192</b>	<b>99,30</b>

Pra, siç shihet nga tabela gjatë vitit 2014 QSUT ka realizuar 100% zërin mallra dhe shërbimi duhe shfrytëzuar në këtë mënyrë të gjithë shumën e alokuar nga FONDI për këtë zë dhe mbi të gjitha duke mos krijuar asnjë borxhe, praktikë që ka shkatërruar financat e QSUT në periudhën 2008 – 2013. Normë të kënaqshme realizimi kanë edhe shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore të cilat janë realizuar përkatësisht me 98% dhe 99.5%. Për sa i përket zërit Investime edhe pse realizimi është rreth 95% sërish theksojmë se vlera e realizimit përfaqëson vlerën e prokuruar nga QSUT dhe pjesa e pa realizuar e fondeve realisht është një kursim e fondeve të buxhetit të shtetit për shkak të uljes së çmimit gjatë realizimit të procedurave konkurruese.

### **1.1. Plani i investimeve**

Për sa i përket investimeve gjatë vitit 2014 në QSUT puna është përqendruar në përfundimin e projekteve të nisura që më parë por edhe në disa projekte të reja ndërtimore dhe furnizim vendosje pajisjesh mjekësore për Shërbimet e QSUT. Konkretisht gjatë vitit 2014 ka përfunduar rikonstruksioni i Spitalit të Neurologjisë. Përfundimi i punimeve të ndërtimit të këtij Spitali u shoqërua me një projekt tjetër për blerjen dhe furnizimin me pajisje hotelerie për këtë spital, duke e bërë këtë shërbim një nga më bashkëkohore në QSUT. Gjithashtu gjatë vitit 2014 ka përfunduar punimet për akseleratorin linear në Shërbimin e Neurokirurgjisë. Përveç këtyre projekteve ndërtimore ka pasur edhe tre projekte të tjera për blerje pajisjesh mjekësore. Konkretisht për Shërbimin e ORL me fonde të akorduara nga Ministria e Shëndetësisë është blerë një aparat lazeri që do të sjellë një përmirësim të mëtejshëm të ofrimit të shërbimit për pacientët nga ky Shërbim. Gjatë 2014 ka pasur një projekt tjetër me vlerë 40.5 milion lekë në kuadër të të cilit janë blerë disa aparatura mjekësore për Shërbimin e Kardiokirurgjisë. Së fundi, me një projekt me vlerë 59 milion lekë është blerë një aparat i ri angiografi për Shërbimin e Hemodinamikës. Aktualisht po punohet për përshtatjen e ambienteve në të cilat do të instalohet kjo aparaturë mjekësore dhe me instalimin e kësaj aparature pritet një përmirësim rrënjësor i si në sasi ashtu edhe në cilësi i shërbimit të ofruar për pacientët.

Krahas projekteve të sipërcituara gjatë 2014 përfunduan të gjitha procedurat e prokurimit dhe marrjes së lejeve të nevojshme për ndërtimin e bunkerit për dy akselerator linear që do të instalohen pranë Shërbimit të Onkologjisë. Projekti i ndërtimit të këtij bunkerit pritet të përfundojë brenda vitit 2015 dhe për pasojë pritet që gjatë vitit 2016 akseleratori i parë që do

të instalohet të filloi funksionimin e tij. Gjithashtu gjatë pjesës së dytë të vitit 2014 kanë përfunduar hartimi i projektit për rikonstruksionin e godinës së ish laboratorit bakterologjik dhe përshtatjen e tij si godinë konsultash në QSUT. Synimi me këtë projekt është grumbullimi i konsultave në një godinë, proces që dot ë përmirësonte menaxhimin e këtij procesi por që do të ndihmonte gjithashtu edhe në uljen e fluksit të panevojshëm të pacientëve dhe personave të tretë që aktualisht për të kryer këto konsulta rrisin në mënyrë të ndjeshme flukset e lëvizjeve në pavijonet në shtretër të QSUT.

Në tabelën në vijim jepen të detajuara projektet e investimit të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe të realizuara gjatë vitit 2014 nga QSUT.


Nr	Emërtimi i projektit	Vlera e plote e projektit	BUXHETI 2014 / LEKE		
			Plani i celur per 2014	Vlera e Prokuruar me tvsh	Vlera e Realizuar
1	Ndertimi i bunkerit per instalimin e akseleratorit linear ne spitalin e Neurokirurgjise dhe rikonstruksioni i Neurologjise ne QSUT dhe shtese kontrate per te dy objektet	313.256.090	64.212.663	313.256.090	64.212.663
2	Superv+kolaudim per ndertimin e bunkerit per instalimin e akseleratorit linear ne spitalin e Neurokirurgjise dhe rikonstruksioni I Neurologjise dhe shtese kontrate per te dy objektet	3.570.480	1.000.000	3.570.480	1.000.000
3	Projekt preventiv per ndertimin e bunkerit per instalimin e dy akseleratoreve linear ne Spitalin Onkologjik	2.386.800	2.400.000	2.386.800	2.386.800
4	Ndertim bunkeri per instalimin e dy akseleratoreve linear ne spitalin onkologjik	218.472.455	5.000.000	218.472.455	<b>4.999.632</b>
5	Supervizion per ndertim bunkeri per instalimin e dy akseleratoreve linear tek spitali onkologjik	1 682 400	200.000	2.624.400	200.000
6	Blerje aparati lazeri per sherbimin e ORL ne QSUT	3.540.000	3.540.000	3.540.000	3.540.000

7	F.v aparat mamografie portable ( 2 cope) per sherbimin e onkologjise ne QSUT	42.988.800	42.988.800	42.988.800	42.988.800
8	F.v aparatura mjekesore per sherbimin e kardiokirurgjise ne qsut	40.560.000	40.560.000	40.560.000	40.560.000
9	Furnizim vendosje pajisje hotelerie per Sherbimin e Neurologjise ne QSUT	24.741.288	25.000.000	24.741.288	24.741.288
10	Projekt preventiv zbatimi per rikonstruksionin e nderteses se ish- labororit bakterologjik per pershtatje per qendren e konsultave ne QSUT	1.600.000	1.600.000	1.596.000	1.596.000
11	F.v aparat Koronografie (angiograf) ne QSUT	59.700.000	59.700.000	59.040.000	59.040.000
12	F.v i disa pajisjeve per funksionimine rezonances manjetike ne sherbimin e Neurokirurgjise dhe Neurologjise	10.584.000	10.584.000		0
13	F.v I disa pajisjeve per funksionimin e CT Scannerit ne sherbimin e Urgjences se Semundjeve te Brendshme ne QSUT.	1.430.000	1.430.000		0

## **1.2. Të ardhurat dytësore të realizuar**

Në kuadër të zbatimit të sistemit të referimit në QSUT janë ngritur dhe funksionojnë 17 recepsione dhe arka. Gjatë vitit 2014 këto arka kanë realizuar një të ardhur në vlerën 61.864.600 lekë, vlerë që është rreth 42% më e lartë krahasuar me vitin 2013 dhe rreth 27% më shumë se në vitin 2012.





Në tabelën në vijim jepen të detajuara të ardhurat e realizuara prej 17 arkave për periudhën 2012 – 2014.

NR.	EMERTIMI	2012	2013	2014
1	KONSULTAT E PERGJITHSHME	3.024.500	1.846.100	2.504.200
2	SPITALI FRANCEZ	4.952.700	3.450.100	6.589.100
3	SPITALI NR.1 (6 KATESHI)	5.538.200	5.971.000	9.130.000
4	SPITALI NR.2	4.442.700	4.510.050	6.314.200
5	SPITALI NR.3 (PEDIATRIA)	1.800.900	1.373.100	2.382.800
6	SPITALI NR.4 (INFEKTIVI)	596.100	464.700	485.200
7	SPITALI NR.5 ( NEUROLOGJIA)	869.500	440.000	245.000
8	SPITALI ONKOLOGJIK	4.265.100	3.099.300	4.973.600
9	SPITALI ORTOPEDIK	1.004.400	670.860	972.100
10	KARDIOKIRURGJIA	1.183.970	1.117.400	921.000
11	LABORATORI QENDROR	1.731.600	800.400	2.687.000
12	IMAZHERIA	858.700	667.200	1.069.900
13	SPITALI NR3/1	782.300	735.500	926.000
14	SPITALI NR.5/1(NEUROKIRURGJIA)	2.075.000	2.019.000	3.565.000
15	ISKSH	13.374.450	14.426.300	12.909.000
16	REOMATOLOGJIA	1.201.600	582.500	785.000
17	SPITALI I RI	1.097.500	1.376.800	5.405.500
	<b>TOTALI</b>	<b>48.799.220</b>	<b>43.550.310</b>	<b>61.864.600</b>

Përveç të ardhurave dytësore të realizuara si pasojë e zbatimit të sistemit të referimit, QSUT realizon edhe të ardhura të tjera kryesisht prej parkimit brenda territorit të QSUT. Theksojmë se parkimi i është dhënë më koncesion një subjekti privat dhe të ardhurat nga parkimi janë në

vlerë fikse sipas termave të koncesionit për operator ekonomik. Në tabelën në vijim jepen të ardhurat totale të realizuara nga QSUT për vitin 2014.

NR.	EMERTIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NETOR	DHJETOR	TOTALI
1	Konsulta & Sherb.Ambulator	5.161.850	5.083.700	5.333.800	5.671.950	5.207.650	5.062.250	4.380.900	3.987.000	5.752.400	6.091.450	5.099.050	5.032.600	61.864.600
2	Qera & Parking	1.169.049	1.168.899	1.221.894	1.338.189	1.169.450	1.154.829	1.226.765	1.229.705	3.258.237	1.177.925	1.263.085	2.802.961	18.180.988
	<b>TOTALI</b>	<b>6.330.899</b>	<b>6.252.599</b>	<b>6.555.694</b>	<b>7.010.139</b>	<b>6.377.100</b>	<b>6.217.079</b>	<b>5.607.665</b>	<b>5.216.705</b>	<b>9.010.637</b>	<b>7.269.375</b>	<b>6.362.135</b>	<b>7.835.561</b>	<b>80.045.588</b>

## **2. Burimet njerëzore**

Menaxhimi i burimeve njerëzore në një institucion me përmasat e QSUT është tejet i domosdoshëm dhe bazë për të pasur një institucion të konsoliduar. Pasja e një strukture tejet të madhe krahasuar me institucione të ngjashme në vend bënë të domosdoshme pasjen e rregullave të qarta për mënyrën e menaxhimit të këtyre burimeve njerëzore. Kështu që gjatë vitit 2014 një nga objektivat kryesore në drejtim të burimeve njerëzore të QSUT ka qenë hartimi i një rregulloreje të brendshme të funksionimit të institucionit. Theksojmë se institucioni ka disa rregulla të veçantë të hartuara që prej vitit 2007 por që nuk i përshtaten realitetit aktual të QSUT dhe mbi të gjitha këtë rregulla të veçantë nuk janë të përfshira në një rregullore të përgjithshme të funksionimit të institucionit. Puna për hartimin e kësaj rregulloreje është përqendruar në dy drejtim: a) rregullat administrative të punës në administratë dhe b) rregullat profesionale në shërbimet mjekësore. Për sa i përket pjesës administrative në draftin e rregullores së re të QSUT janë përcaktuar qartë detyrat që ka çdo njësi e Drejtorisë së Përgjithshme e QSUT si dhe janë përcaktuar proceset e përkatëse të punës për këto njësi, duke iu përmbajtur në çdo rast kuadrit ligjor në fuqi mbi të cilin këto njëri mbështesin punën e tyre të përditshme. Ndërsa për sa i përket pjesës mjekësore të kësaj rregullore është mbajtur parasysh që këto rregulla të jenë në përputhje me rregulluar profesionale si Urdhëri i Mjekut, Urdhëri i Infermierit etj. Drafti i ri i rregullores së QSUT është përfunduar dhe i është nisur për miratim Bordit të QSUT.

Në raportin e kontrollit të veprimtarisë së QSUT për vitin 2013, Kontrolli i lartë i Shtetit ka konstatuar disa parregullsi lidhur me numrin e të punësuarve më kontratë nga ana e QSUT gjatë vitit 2014 por edhe vitet e mëparshme. Duke ju përmbajtur këtij konstatimi të KLSH, është punuar gjatë gjithë vitit 2014 për sjelljen e kësaj strukture (në këndvështrimin e numrit të punonjësve) në parametrat e miratuar me ligj. Konkretisht gjatë vitit 2014 janë prishur xx kontrata pune për punonjës që ishin jashtë strukturës së miratuar.

## **3. Shërbimet mbështetëse**

Struktura tejet e madhe e QSUT-së dhe numri i pacientëve të cilët marrin shërbim spitalor në të vetmen qendër terciare në vend, bëhet e domosdoshme pasja e një infrastrukture të përshtatshme në mbështetje të ekipit mjekësor që do të ofrojë shërbimin për pacientët. Në QSUT vepron një drejtori e veçantë e cila ka në themel të punës së saj mbajtjen në funksionim të të gjithë infrastrukturës spitalore por edhe ofrimin e një shërbimi sa më cilësor të hotelerisë në të gjithë spitalet e QSUT.

Për sa i përket shërbimit të gatimit, shpërndarjes dhe servirjes së ushqimit për pacientët në pavionet e QSUT, gjatë vitit 2014 puna është përqendruar në drejtim të njohjes dhe informimit të pacientet lidhur me dietat që ofrohen në QSUT, si dhe rendësinë që këto dieta kanë për trajtimin sa më të mirë të sëmundjes. Duke pasur parasysh se ofrimi i ushqimit nuk ka pasur një rregullore të shkruar për mënyrën e ofrimit të tij, gjatë vitit 2014 është hartuar dhe miratuar *“Rregullorja e Brendshme e Monitorimit të Shërbimit të gatimit, shpërndarjes dhe servirjes së ushqimit për pacientët në pavionet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë”*. Gjithashtu është monitoruar në vijimësi cilësia e ushqimit dhe mënyra e ofrimit të këtij ushqimi nga ana e operatorit ekonomik të kontraktuar për këtë qëllim. Gjatë muajve Tetor - Nëntor 2014, është realizuar një pyetësor ku nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me pacientët ose familjarët e tyre, me synim përcaktimin e performacës aktuale të ofrimit të këtij shërbimi she nivelin e kënaqësisë tek pacientët. Në përfundim të këtij pyetësor rezultoi se rreth 97% e pacienteve të shtruar në QSUT e marrin ushqimin e ofruar nga ana e QSUT dhe 87% e këtyre pacientëve janë të kënaqur me cilësinë e këtij ushqimi.

Një pyetësor i ngjashëm është realizuar edhe për sa i përket shërbimit të lavanderisë në QSUT dhe duhet theksuar se edhe përgjigjet e këtij pyetësor kanë paraqitur një nivel të konsiderueshëm kënaqësie nga ana e pacientëve lidhur me cilësinë e ofrimit të shërbimit dhe cilësinë e materialeve të përdorura për ofrimin e shërbimit të lavanderisë.

Duke pasur parasysh se fundi i vitit 2013 shënoi edhe periudhën e prishjes së kontratave të qerasë më subjektet të cilat ushtronin kryesisht veprimtari shërbimi bar –kafe brenda territorit të QSUT, në verën e vitit 2014 lindi e domosdoshme që puna e pastrimit dhe gjelbërimit të jashtëm të territorit të QSUT të përqendrohej kryesisht për të shtuar sipërfaqet me tapet bari, si dhe është realizuar mirëmbajtja e sipërfaqeve të dëmtuara. Konkretisht është mbjellë me bar sipërfaqja e dëmtuar për anë Spitalit Psikiatrik dhe Neurologjisë. Janë kryer punime toke dhe vazhdojnë ende rreth Spitalit Pediatrik, për të rregulluar sipërfaqet e dëmtura. Njëkohësisht janë mbjellë pemë të ndryshme për të rritur nivelin total të gjelbërimit brenda territorit

Së fundi për sa i përket mirëmbajtjes ndërtimore dhe impajnistike duhet theksuar se janë bërë ndërhyrje për eliminim lagashtie në ambientet e Spitalit Onkologjik, Spitalit të Sëmundjeve të Brendshme dhe Spitalit Pediatrik. Gjithashtu këto shërbime kanë qënë në gadishmëri të plotë për të ofruar shërbim 24 orë në ditë në mbështetje të stafit mjekësor të QSUT.

#### **4. Marrëdhëniet juridike dhe procedurat e prokurimit publik**

Ne zbatim të ligjit nr.9106 date, 17/07/2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji 9643 , date 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik I ndryshuar”, Statuti i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me nr.2364 Prot ,datë 25.06.2007 të Ministrisë së Shëndetësisë , nr.4564/1 prot ,datë 26.06.2007 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, sektori i prokurimeve publike si pjese e struktures se QSUT ka qene i angazhuar dhe i impenjuar per zbatimin e nevojave te te gjithë shërbimeve mjekësore ,drejtorive dhe sektoreve prane ketij institucioni.

Sektori i Prokurimeve Publike ka ndjekur ne menyre te vazhdueshme legjislacionin per prokurimet publike dhe është azhornuar me ndryshimet e tij. Ky sektor ka mbledhur te dhënat nga Shërbimet dhe drejtorite apo sektoret përkatës , ka parashikuar prokurimet publike per vitin 2015. Janë përgatitur dokumentacionet përkatëse dhe janë hedhur në faqen zyrtare të APP përkatësisht ne web-siten [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) rast pas rasti si dhe ka kryer negociimet pa shpallje paraprake per procedurat e tjera ne zbatim te nenit 33 te LPP. Janë nënshkruar kontratat me operatorët ekonomik të shpallur fitues për të gjitha procedurat e prokurimeve te vitit 2014 si ato te zhvilluara nga Autoriteti yne Kontraktor QSUT “Nënë Tereza” dhe për procedurat e përqëndruara të zhvilluara nga oraganet qëndrore blerëse Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendëshme, si dhe u eshte bere njoftimi per kontratat e nenshkruara prane APP.


### **III. TREGUESIT SPITALOR TË QSUT**

Gjatë vitit 2014 ë QSUT janë trajtuar një numër total prej 618.810 pacientësh, përkatësisht 71.000 të shtuar, 271.355 pacient në urgjencat e QSUT dhe si pacient ambulator (të cilët kryejnë kryesisht konsulta me mjekët e QSUT).

Pacientë	2014
<b>Të shtruar</b>	71 000
<b>Në Urgjencë</b>	271 355
<b>Ambulatorë</b>	276 455

#### ***Pacientët ambulatorë***

Në grafikun në vijim paraqitet trendi i pacientëve ambulatorë dhe konsultat që pacientët kanë marrë në QSUT. Siç vihet re edhe nga grafiku numri i këtyre pacientëve nga 73 mijë që ka qenë në vitin 2011 ka arritur në 276 mijë pacientë ambulator në vitin 2014, më një rritje gati katër herë më tepër pacientë në vitin 2014. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm gjatë vitit 2014 pacientët ambulator dhe konsultat në QSUT kanë pësuar një rritje prej 45.7% krahasuar me një vit më parë.



Nëse do të vazhdojmë ti referohemi pacientëve ambulatorë të QSUT vihet re se 83% e tyre janë të pajisur me rekomandim nga mjeku, 66% e tyre kanë qenë të siguruar dhe vetëm 37% e tyre janë detyruar të paguajnë për shkak se nuk kanë pasur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të përfituar sipas sistemit të referimit. Në grafikët në vijim jepen të detajuara të dhënat mbi këta tregues.



### Ndërhyrjet kirurgjikale

Gjatë vitit 2014 në QSUT janë realizuar në total 21.607 operacione, kjo shifër përfaqëson një rritje me 13.2% krahasuar me vitin 2013, vit në të cilin janë realizuar 19.088 ndërhyrje kirurgjikale në të gjitha shërbimet e QSUT. Tabela në vijim jep të detajuar numrin e operacioneve në të 16 sallat operatore që zotëron QSUT.

Shërbimet	Nr. i Operacioneve sipas Shërbimeve viti 2014
<b>Kirurgji Pediatrike</b>	3 675
<b>Okulistikë</b>	3 351
<b>Klinika I</b>	1 900
<b>Klinika III</b>	1 877
<b>Ortopedi-trauma</b>	1 814

<b>Onkologjik</b>	1 720
<b>Urologji</b>	1 570
<b>ORL</b>	1 547
<b>Plastika</b>	1 168
<b>Neurokirurgji</b>	973
<b>Angiologji</b>	816
<b>Kardiokirurgji</b>	700
<b>OMF</b>	496
<b>TOTALI</b>	<b>21 607</b>


Pra siç shihet nga tabela numri më i lartë i ndërhyrjeve kirurgjikale është kryer në Kirurgjinë Pediatrike ku janë realizuar 3.675 ndërhyrje e ndjekur nga Okulistikë e cila ka realizuar 3.351 ndërhyrje gjatë vitit 2014.

### *Shërbimet e Urgjencave në QSUT*

Gjatë vitit 2014 në të gjithë urgjenat e QSUT kanë marrë shërbime spitalore rreth 271 mijë pacientë. Krahasuar me vitin 2013 vihet re një rritje prej 40% e numrit të pacientëve të trajtuar.

<b>Vitet</b>	<b>VIZITA</b>	<b>KTHIME</b>	<b>SHTRIME</b>	<b>VDEKJE (%)</b>	<b>RISH. 72 OR.</b>
<b>Viti 2011</b>	157 254	116 709	30 913	212 (0.13)	30 821
<b>Viti 2012</b>	168 827	136 307	24 434	268 (0.16)	30 644
<b>Viti 2013</b>	192 758	156 540	26 439	323 (0.17)	40 619
<b>Viti 2014</b>	271 355	243 388	27 826	141 (0.05)	34 372

Ndërkohë nëse do ti referohemi treguesve të tjerë të shërbimit në urgjenca vërejmë se niveli i vdekshmërisë në urgjenca gjatë vitit 2014 ka qenë tejet i ulët vetëm në 0.05%, ndërkohë që numri i rishtrimeve është ulur në vetëm 34 mijë raste e cila përbënë vetëm 12% të totalit të vizitave në Urgjenca gjatë vitit 2014.



Në vijim paraqiten të detajuara vizitat në secilën prej urgjencave të QSUT.

Shërbimet e Urgjencave	VIZITA	KTHIME	SHTRIME	VDEKJE (%)
Urgjenca e Djegie-Plastikës	6 809	6 425	383	1
Urgjenca e Infektivit	23 730	21 089	2 641	0
Urgjenca e Sëmundjeve të Brendshme	86 948	81 621	5 190	137
Urgjenca e Specialiteteve	12 604	11 235	1 369	0
Urgjenca Kirurgjikale	39 676	36 255	3 421	0
Urgjenca Pediatrike	92 360	78 937	13 420	3
Urgjenca e Psikiatrisë	9 228	7 826	1 402	0
<b>TOTALI:</b>	<b>271 355</b>	<b>243 388</b>	<b>27 826</b>	<b>141 (0.05)</b>


Siç edhe shihet nga tabela numri më i madh i vizitave gjatë vitit 2014 është realizuar në Urgjencën Pediatrike i ndjekur nga Urgjenca e Sëmundjeve të Brendshme. Ndërkohë që për sa i përket rasteve të vdekjeve në urgjencë numri më i madh i tyre, me 137 raste është shënuar në Urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme.

#### *Ekzaminimet imazherike*

Gjatë vitit 2014 në QSUT është realizuar një numër total prej 112.745 ekzaminimesh imazherike, me një rritje prej 44% krahasuar me vitin 2013. Interesant është fakti që gjatë vitit 2014 ka një ndryshim rrënjësor nga përdorimi i ekzaminimeve speciale (rezonancë manjetike dhe CT Scanner) për tek ekzaminimet tradicionale.

Viti	Imazheri tradicionale (Eko+Ro-Grafi+Ro-Skopi)	RM	CT	Totali
Viti 2013	46174	10043	21924	78141
Viti 2014	94082	4964	13699	112745

Ndërsa po të analizojmë në detaje llojet e ekzaminimeve që kryhen në QSUT, situata do të paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm. Rreth 47% e totalit të ekzaminimeve që kryhen në QSUT janë ekografi e ndjekur nga rentgenografi me 25% të rasteve.



### **Ekzaminimet laboratorike**

Në tabelën në vijim jepen të detajuara ekzaminimet laboratorike të cialt janë realizuar në të gjithë laboratorët e QSUT. Në total gjatë vitit 2014 janë realizuar 2.2 milion ekzaminime laboratorike, nga të cilat në Laboratorin Biokimik – Klinik janë realizuar 2.1 milion ekzaminime. Krahasuar me vitin 2013 ky numër ekzaminimesh përfaqëson një rritje prej 21.6% ndërsa po të bëjmë një krahasim me vitin 2012 rritja kap është tejet e ndjeshme duke e çuar numrin e ekzaminimeve më shumë se tre herë më shumë.

<b>Nr.</b>	<b>Laboratorët QSUT</b>	<b>Viti 2012</b>	<b>Viti 2013</b>	<b>Viti 2014</b>
<b>1</b>	Laboratori Biokimik-Klinik	437 025	1 778 363	2 150 222
<b>2</b>	Laboratori Mikrobiologjik	24 249	25 029	24 056
<b>3</b>	Laboratori Imunologjik	12 594	11 407	31 133
<b>4</b>	Laboratori Anatomo-Patologjik	12 154	15 845	20 764
<b>5</b>	Laboratori Gjenetik	40	184	126
<b>TOTALI:</b>		<b>486 062</b>	<b>1 830 828</b>	<b>2 226 301</b>

### **Aktiviteti Farmaceutik**

Gjatë vitit 2014 në total në QSUT është konsumuar një sasi medikamentesh që kap vlerën prej 2.560.986.985 lekë, sasi e cila është rreth 12% më shumë se sasia e konsumuar në vitin 2013. Nëse do i referohemi grafikut të mëposhtëm të konsumit mujor të medikamenteve gjëja që ja vlen të theksohet është një lloj njëtrajtshmërie në konsum, e cila reflekton më së miri faktin që furnizimi me medikamente i QSUT ka qenë i vazhdueshëm dhe që menaxhimi i shërbimit farmaceutik ka qenë në nivel e duhur. Vlen të theksohet gjithashtu fakti që asnjë nga medikamentet e blera në periudhën e fundit të vitit 2013 dhe gjatë vitit 2014 nuk kanë skaduar gjatë vitit 2014, fakt që flet për një planifikim të mirë dhe të saktë të nevojave të shërbimeve për medikamente.

